



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

VENDIM
Nr. 344, datë 02.09.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjergji Baçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Shpërblim dëmi jashtëkontraktor”.
2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Yrfet Shkreli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, çështjen civile me Paditës: {...}; Të paditur: {...}, etj.; Objekti: “Shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror”.
3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Yrfet Shkreli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, çështjen gjyqësore me Kërkesë: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor; Objekti: “Pushim procedimi penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, Blerta Marku (Çibuku), caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen civile me Paditës: {...}; E paditur: {...}; Objekti: Shpërblim dëmi.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Yrfet Shkreli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen civile me Paditëse: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Shpërblim dëmi”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjergji Baçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen civile me Paditës: {...}; Të paditur: {...}, {...}, etj.; Ndërhyrës kryesor: {...}, {...}, etj.; Objekti: “Anulimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave”.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Suela Dashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen penale me të pandehur: {...}, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve mbetur në tentativë, në bashkëpunim” parashikuar nga neni 283/a, në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Arben Dosti, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen gjyqësore me Viktima akuzuese: {...}; I akuzuari: {...}; Objekti: “Gjykimin e të akuzuarit për veprat penale të “Fyerjes” dhe “Shpifjes”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}dhe {...}; Akuza: “Fallsifikim i monedhave” e “Drejtimit automjeti në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga nenet 183 e 291 të Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TROPOJË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Sami Ujkashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen gjyqësore me Kërkuese: {...}; Palë e interesuar: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor{...}; Objekti: Heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar dhe caktim kujdestari ligjor për shtetasen {...} e bija e {...} dhe {...} e lindur në datë 27.05.1969.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Sami Ujkashi dhe Merita Karaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë{...}; Objekti: “Kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal me nr.68 të vitit 2020, në ngarkim të të pandehurëve {...}, {...}, {...}dhe {...}, të akuzuar për kryerjen e veprave penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, kryer në bashkëpunim dhe “Kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/2 dhe 284/1 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Suela Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin; I pandehur: {...} etj; Akuza: “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga neni 79/b – 22 dhe 278/1 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Lutfije Celami, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 76 e 22 i Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Klejda Çapja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vrasje e funksionarëve publike”, mbetur në tentativë”, parashikuar nga neni 79/a e 22, 76 e 22, 278/1 dhe 100/2 i Kodit Penal.

GJYKATA E APELIT DURRËS

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata (relatore), Astrit Kalaja dhe Tonin Sterkaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me Kërkuese: {...}; Objekti: “Mosfillimi i procedimit penal”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Nazmi Troka dhe Skënder Damini, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Kthim shume, sigurim padie etj”.

2. Gjyqtaret e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali dhe Iliba Bezati, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me Paditës: Këshilli i Ministrave; Të paditur: {...}, {...}, etj.; Objekti: “Shfuqizim vendimi nr.322/1996 të ish {...}, etj.

3. Gjyqtaret e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali dhe Iliba Bezati, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me Paditës: {...}; Të paditur: {...}, etj.; Objekti: “Njohje e të drejtës së pronësisë, etj.”

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Iliba Bezati, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}Objekti: “Kundërshtim vendimi mosfillimi”.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}; Akuza: “Shpërdorim detyre”, “Vjedhje duke shpërdoruar detyrën”.

6. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Viktimë akuzuese: {...}; Akuza: Dhunim i banesës etj.

7. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Plagosje e lehtë me dashje”.

8. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Nazmi Troka (relator), Skënder Damini dhe Laurent Fuçia, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit

Gjirokastër, çështjen penale me Kallëzues: {...}; Të pandehur: {...}, {...}, {...}; Akuza: “Falsifikimi i dokumentave, Shpërdorim detyre, etj.”

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me Paditës: {...}; E paditur: {...}, {...}; Objekti: “Dëmshpërblim page”.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Ridvan Hado, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, e mbetur në tentativë”.
3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Dhunë në familje”.
4. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vrasje me dashje, mbetur në tentativë”.
5. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, “Moskallëzim krimi”.
6. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Ridvan Hado, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vjedhje”.
7. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.
8. Gjyqtaret e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elbana Lluri dhe Elona Toro, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Largimi i te burgosurit nga vendimi i qëndrimit”.
9. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Ridvan Hado dhe Edlira Petri, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”; “Mosbindje ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik”; “Largim nga vendi i aksidentit”.
10. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elbana Lluri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Mashtrim.
11. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vjedhje”.

12. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vjedhje”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me Paditës {...}; Objekti: “Kundërshtim vendimi”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 323/1 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici dhe Valbon Çekrezi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 124/b e 130/a të Kodit Penal”.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, çështjen administrative me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr.74, datë 06.01.2017 i Këshillit të Bashkisë Krujë “Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2017”, etj.”

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, çështjen administrative me Paditës: {...}; I paditur: {...}, {...}; Objekti: “Të më llogarisë dhe të më paguajë pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi, të indeksuar në masën e përcaktuar nga aktet nënligjore dhe VKM përkatëse. Rillogaritja të bëhet sipas nenit 11 të ligjit nr. 8087 dt. 13.03.1996 të ndryshuar, i cili parashikon si shumë të pensionit, masën prej 50% të pagës referuese duke i shtuar 2% të kësaj page, për çdo vit tjetër shërbimi mbi vjetërsinë prej 15 vjetësh...”

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Tonin Sterkaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, çështjen administrative me Paditës: {...}; I Paditur: {...}; Person i tretë: {...}, Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të paluajtshme Shkodër; Objekti: “Anullimin e lejes së legalizimit të objektit informal në pronësi të shtetasit {...}, të lëshuar nga pala e paditur për ndërtimin informal mbi pasurinë me nr. 7/664 volum 42, faqe 234, ZK 8591 Shkodër”.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, çështjen administrative me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Detyrimi i palës së paditur që të bëjë rillogaritjen e pensionit të parakohshëm për paditësin sipas ligjit nr. 8087, datë 13.03.1999 i ndryshuar me ligjin nr. 9210 datë 23.03.2004. Detyrimin e palës së paditur të rillogarisë masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi m 50% të pagës referuese dhe për çdo vit shërbimi mbi 15 vjet të shtohet me 2% të pages referuese. Detyrimin e palës së paditur të bëjë kthimin e diferencave të papaguara si rezultat i llogaritjes së gabuar të pensionit të parakohshëm që nga data 01.09.2006 deri në pensionin e plotë të pleqërisë.”

5. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Vojsava Osmanaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, çështjen administrative me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Palë e tretë: {...}; Objekti: “Kërkoj të detyrohet pala e paditur {...}të më paguaj pensionin e pjesshëm sipas statusit të ushtarakut miratuar me ligjin nr. 7496, dt. 03.07.1991, neni 16 i tij etj”.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Vojsava Osmanaj si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 283/a/1, 284/c, 28/4, 333/a/2 e 334/1 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/1, 334/1, 109/1 e 25 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR